8816

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 8816 VEND;

# V E N D I M

## PER RI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Une Gjyqtarja e Gjykates rrethit Tirane Florina Tepu pasi studiova kerkesen e Ndermarjes"LORENZO -TIRANA" e perfaqesuar nga ORTAKET ILIR HAXHIYMERI dhe MASSIMO ALIVERTI,te cilet kerkojne qe te ri regjistrohen si person juridik:

## K O N S T A T O V A

Ndermarja "LORENZO-TIRANA" eshte regjistruar si person juridik ne Gjykaten e Rrethit Tirane me vendimin Nr.879 date 21.09.1991 PER TE ushtruar aktivitet ne fushen e prodhimit dhe shitjen e llullave kryesisht per eksport.

Po me vendimin Nr.20 date 22.09.1993 eshte rivendosur ne afat ri regjistrimi i kesaj ndermarje ne baze te ligjit Nr.7638 date 19/11.1992"PER SHOQERIT TREGETARE" dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "PER REGJISTRIMIN TREGETAR".

Dokumentacioni i paraqitur nga kjo ndermarje i ploteson kushtet per te emertuar si SHOQERI TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR me emertimin "LORENZO TIRANA" SH P K .

## PER KETO ARSYE

Si Gjyqtare e vetme e bazuar ne ligjin Nr.7638 date 19/11/1992 dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993.

## V E N D O S A

Ri regjistrimin e Ndermarjes "LORENZO -TIRANA" si SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR me administrator Z.ILIR HAXHIYMERI,me seli ne Tirane rruga QEMAL STAFA NR.390,me objekt prodhimin dhe shitjen e llullave kryesisht per eksport, kohezgjatja 10 vjet,kapitali i SHOQERISE TREGETARE SH P K eshte 788.220 dollar usa.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit.

U shpall sot me daten 29 .12.1993

G J Y Q T A R J A

Florina Tepu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
Nr. 2816/1 Vendimit

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TË VETËM

Unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Florina Tegu sot më dt.19.1.1996, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga administra-
ri i Shoqërisë "Lorenco Tirana"shpk Ilir Hazhiymeri dhe:

## K O N S T A T O V A

S, me vendimin dt.19.1.1996 të asamblesë së ortakëve të shoqë-
-risë "Lorenco Tirana " ka vendosur shtimin e objektit të veprimta-
-risë së shoqërisë në fushën e nxjerrjes,grumbullimit,transportit e
përpunimit të rrënjës së shqopës dhe marosë për prodhimin e llullave
si dhe Eksport- import e lëndëve të para e ndihmëse,pajisjeve e maki-
-nerive për prodhimin e llullave.Aktet e paraqitura me këtë rast në
gjykatë janë të plota dhe në vështrim të nenit 24 të ligjit 7667, dt
28.1.1993 qmoj se kërkesa e paraqitur nga administratori duhet pranua

## PËR KËTO ARËSYE

Në bazë të nenit 24 e 33 të ligjit 7667, dt.28.1.1993

## V E N D O S A

Depozitimin, në zyrën e regjistrit Tregtar të vendimit datë 11.1.1996 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë " Lorenco Tiranë"shp duke bërë shënimin në fletën përkatëse të regjistrit në kollonën 4 e 5 me nr. rendor 2.Të ndahen regjistrimet nga njëri tjetëri me vijë të kuqe.

Tiranë më 19.1.1996

G J Y Q T A R E
/ FLORINA TEGU /
Tegu

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 8816/2

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 02. 11 1998, une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Ilir Haxhiymeri, i cili kerkon te depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve per shtese objekti ne veprimtarine e shoqerise "LORENZO TIRANA" SHPK dhe;

KONSTATOVA;

Me vendimin nr. 8816/1, date 19.01.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane eshte shtuar objekti i veprimtarise se shoqerise LORENZO TIRANA SHPK.

Me vendimin nr.2 date 19.10.1998 Asambleja e Ortakeve ka shtuar objektin e veprimtarise se shoqerise edhe ne ;
Ne fushen e permiresimeve pyjore ( per zbatimin e punimeve).

Kerkoj te behen keto ndryshime ne skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrit Tregtar prane Gjykates suaj.
Kerkesa e saj per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri per shtese objekti edhe ne Skeden Perkatese te kesaj shoqerie , eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

VENDOSA ;

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Ilir Haxhiymeri te shoqerise "LORENZO TIRANA" SHPK per depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.2, date 19.10.1998 per te shtuar objektin e veprimtarise te sipershenuar duke u bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen e 2, germa c, kollonat 4 e 5 me numer rendor 2 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE
Pinelo Copo

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 88/16/3 VENDIMI

6681

# V E N D I M

## "I GJYQTARIT TE VETEM"

Sot,me date 08.06.1999,une gjyqtare e gjykates se rrethit Tirane,Anila Capo,mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit z.Ilir Mexhiymeri administratori i shoqerise"LORENZO TIRANA"SH.P.K. me seli ne Tirane dhe:

## K O N S T A T O V A

Se,kerkesa e bere nga kerkuesi,administratori dhe ortak i shoqerise"LORENZO TIRANA"SH.P.K. qe eshte rregjistruar prane rregjistrit tregetar te gjykates se rrethit Tirane me NR.2816.date 29.12.19993,me seli ne Tirane,me dy ortake z.Massimo Alliverti dhe Ilir Mexhiymeri,me kapital 768.40200 dollare, ku 45% te kapitalit jane te shtetit dhe 55% te kapitalit jane te shoqerise,me objekt prodhim te llullave,me kohezgjatje mbi 10-vjet,

Gjithashtu duke pare dhe dokumentacionin si vendimin e asamblese me NR.46/Prot date 21.05.1999,ku mori ne shqyrtim kontraten e shitjes se kapitalit shteteror ne kete shoqeri,ku kapitali i zoteruar nga shteti 45% ne vlere leku 33.004.735 lek,gjithashtu dhe kontraten e shitjes me NR.1068.Rep dhe NR.179/Kol date 05.05.1999,te noterit Andon Pano;

Pra duke pare te gjithe dokumentacionin kerkesa eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet pranuar dhe:

## PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992.

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses,

Depozitimin e vedimit te asamblese NR.46/prot date 21.05.1999 kontraten e shitjes me NR.1068./Rep dhe NR.179/Kol date 05.05.1999 te noterit Andon Pano

Urdherimin e zyres se rregjistrit tregetar te beje ndryshimet ne NR.rendor 465,kollonen 6

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

/ANILA CAPO/

PULLE TAKSE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**Vendimi Nr. ~~11520~~/3** 8816/2

**VENDIMI I GJYQTARIT TE VETEM**
**PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK**

Sot me dt.07 02.2002 une Anila Capo Gjyqtare pranc Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga shoqeria "LORENZO - TIRANA." shpk, perfaqsuar nga ortaku dhe administratori Aliverti Massimo i per depozitimin e vendimit Nr 18/3 dt.14.02.2002 te ortakut te vetem "Per rivlersimit e kapitalit themelor te shoqerise ,ndarjes se ketij kapitali ne 100 kuota si dhe te vleres nominale te nje kuotave etj .

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "LORENZO - TIRANA." shpk eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar me vendimin N8616. dt.29.12.1993 te Gjykates se Rrethit Tirane me ortake "Lorenzo" srl, person juridik me aktivitet ne Itali Gallarata (Va) Rr. "Passo del Gottardo'Nr 15 si dhe ndermarrja shteterore e Ilullave.

Me vendimin e depozitimit marre nga Gjykata e Rrethit Tirane me Nr. 8816/3 eshte bere ndryshimi i marredhenieve te ortakerise si pasoje e privatizimit te kuotave te ortakut shteteror nga 'Lorenzo' srl dhe ku rezulton qe sot shoqeria "Lorenzo – Tirana" shpk perbehet vetem nga nje ortak, perfaqesuar nga administratori Massimo Aliverti.

Me dt. 11.02.2002 eshte depozituar kerkesa me Nr. 11520/3 per emerimin e ekspertit Berti Pashko ne kuadrin e vleresimit te kapitalit themelor te shoqerise dhe te vleres nominale te cdo kuote.

Me vendimin Nr. 18/3 dt. 14.02.2002 ne vijim dhe te vendimit te meparshem te marre po nga ortaku i vetem eshte vendosur te miratohet materiali i paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar Berti Pashko, me Nr. licence 7 dt. 10.02.2000 te leshuar nga I.E.K.A. dhe mbi bazen e ketij materiali ekspertize kontabel rezulton se kapitali themelor i shoqerise eshte ne vleren 50.000.000 leke dhe po ky kapital i shoqerise ndahet ne 100 kuota me vlera nominale te nje kuote eshte barabarte me 50.000 leke.

Gjithashtu, ne kete mbledhje eshte miratuar ndryshimi i nenit 13 te Aktit te themelimit te shoqerise ne lidhje me afatin kohor te aktivitetit nga 10 vjet ne nje periudhe kohore per ushtrim aktiviteti mbi 10 vjet

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne aneksin e tij te vendimitNr18/3 dt. 14.02.2002 te ortakut te vetem te shoqerise "LORENZO - TIRANA." shpk, si dhe praktikes perkatese te mbledhjes ku eshte vendosur;

-Miratimi i raportit perkates per rivlersimin e kapitalit themelor te shoqerise ne shumen prej 50.000.000.leke ,ndarjen e kapitalit themelor ne 100 kuota dhe per rrjedhoje vlera e nje kuote eshte ne shumen prej 50.000leke.

-Miratimi i ndryshimeve ne aktin e themelimit te shoqerise te nenit 13 te saj ne lidhje me zgjatjen e afatit kohor te zhvillimit te aktivitetit nga 10 vjet ne mbi 10 vjet.

- Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje shenimet perkatese ne kuadrin e depozitimit te ketij vendimi.

Shpallur sot me dt.07.02.2002

Gjyqtare
Anila Capo

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**Vendimi Nr. ~~11520/3~~ 8816/3**

## VENDIMI I GJYQTARIT TE VETEM PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK

Sot me dt. 11.02.2002, une Enkela Bajo, gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga ortaku i vetem i shoqerise "LORENZO - TIRANA" shpk, perfaqsuar nga ortaku dhe administratori i vetem Massimo Aliverti per depozitimin e vendimit Nr. 18/2 prot. dt. 20.01.2002 i ortakut te vetem percaktimin e ekspertit kontabel te autorizuar ne kuadrin e rivleresimit te kapitalit themelor dhe te cdo kuote nominale te shoqerise.

KONSTATOVA:

Se shoqeria "LORENZO - TIRANA" shpk eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar me vendimin Nr.8816 dt. 29.12.1993 me ortake "Lorenzo" srl, person juridik me aktivitet ne Itali ne Gallarata (VA), perfaqesuar nga Massimo Aliverti, si dhe nga ndermarrja e prodhimit te llullave, perfaqesuar nga Ilir Haxhiymeri.

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8816/3 dt. 09.06.1999 eshte vendosur pranimi i kerkeses per depozititmin e vendimit te Asamblese se Ortakeve me Nr. 46/prot. dt. 21.05.1999 – mbi miratimin e blerjes se pjeses se kapitalit te ortakut shteteror dhe perfundimisht shoqeria "LORENZO – TIRANA" shpk sot perbehet nga ortaku i vetem "Lorenzo" srl, perfaqesuar nga kerkuesi Massimo Aliverti.

Me dt.20.01.2002 eshte vendosur nga ortaku i vetem me cilesin e dhe atributet e asamblese se ortakeve me vendimin Nr.18/2 noteruar me267 Rep. dhe Nr.58 Kol. ka vendosur te emeroje si ekspert kontabel te autorizuar Berti Pashko per vlersimin perfundimtar te kapitalit te shoqeris dhe dhe te cdo kuote

Rezulton qe ekspertja Berti Pashko te plotesoje kushtet prefesionale per realizimin e kesaj detyre sipas dhe licences Nr.7.dt.10.02.200 se leshuar dhe nga "I.E.K.A.

PER KETO ARSYE,

Ne baze te Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne aneksin e tij te vendimitNr 18/2 dt. 20.02.2002 me Nr 267 Ikol dhe 58 kol te marre nga ortaku i vetem perfaqsuar nga Masimo Aliverti te shoqerise "LORENZO - TIRANA" shpk, si dhe praktikes perkatese te mbledhjes se asamblese se ortakeve "- Per emrimin e ekspertes kontabel te autorizuar Berti Pashko Me Nr 7 licence te dt 10. 02.2000 te leshuar nga I.E.KA ne kuadrin e rivlersimit te kapitalit themelor te shoqerise dhe te cdo kuote.

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje shenimet perkatese ne kuadrin e depozitimit te ketij vendimi.

Shpallur sot me dt.11.02.2002.

Gjyqtare
Enkela Bajo

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**Vendimi Nr. ~~11520/4~~** 8816/4

**VENDIMI I GJYQTARIT TE VETEM**
**PER DEPOZITIM AKTESH TE PERSONIT JURIDIK**

Sot me dt.13.05.2005, une gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga perfaqsuesi I Lorence s.r.l. si ortak i vetem i shoqerise "LORENZO - TIRANA" shpk, perfaqsuar nga Massimo Aliverti per depozitimin e vendimit Nr. 18/4 prot. dt. 04.05.2005 marre nga ortaku i vetem per caktimin e nje eksperti kontabel te autorizuar ne kuadrin e zmadhimit te kapitalit themelor nepermjet perdorimit te fitimit dhe ne kete kuader dhe te rivlersimit te kuotave nominale te shoqerise.

KONSTATOVA:

Se shoqeria "LORENZO - TIRANA" shpk eshte regjistruar si person juridik ne regjistrin tregtar me vendimin Nr.8816 dt. 29.12.1993 me ortake "Lorenzo" srl, person juridik me aktivitet ne Itali ne Gallarata (VA), perfaqesuar nga Massimo Aliverti, si dhe nga ndermarrja e prodhimit te llullave, perfaqesuar nga Ilir Haxhiymeri.

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8816/3 dt. 09.06.1999 eshte vendosur pranimi i kerkeses per depozititmin e vendimit te Asamblese se Ortakeve me Nr. 46/prot. dt. 21.05.1999 – mbi miratimin e blerjes se pjeses se kapitalit te ortakut shteteror dhe perfundimisht shoqeria "LORENZO – TIRANA" shpk sot perbehet nga ortaku i vetem "Lorenzo" srl, perfaqesuar nga kerkuesi Massimo Aliverti.

Me vendimin Nr 8816/2 te dt.07.02.2002 eshte vendosur depozitimi I vendimit te asambles se ortakeve ku rezulton qe kapitali themelor I shoqerise te jete 50.000.000. leke dhe vlera e nje kuote te jete 5000.000. leke

Me vendimin I dt.04.05.2005 objekt kerkese per depozitim eshte vendosur nga ortaku i vetem per zmadhimin e kapitalit themelor te shoqerise nepermjet fitimeve te realizuara dhe per realizimin e nje vlersimi konform bilanceve te shoqerise ka vendosur te emeroje si ekspert kontabel te autorizuarAdriatik Beqiraj per vlersimin perfundimtar te fitimit te realizuar te shoqeris dhe te rivlersimit te cdo kuote

Rezulton qe eksperti Adriatik Beqiraj ploteson te gjitha kushtet prefesionale per realizimin e kesaj detyre sipas dhe licences Nr.72 .dt. 20.03. 2000 se leshuar dhe nga "I.E.K.A

PER KETO ARSYE,

Ne baze te Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne aneksin e tij te vendimitNr 18/4 dt. 04.05.2005 me Nr 841kol dhe 132 kol te marre nga ortaku i vetem perfaqsuar nga Masimo Aliverti te shoqerise "LORENZO - TIRANA" shpk, si dhe praktikes perkatese te mbledhjes se asamblese se ortakeve "- Per emrimin e ekspertes kontabel te autorizuar Adriatik Beqiraj Me Nr 72 licence te dt 20.03.2000 te leshuar nga I.E.KA ne kuadrin e zmadhimit t te kapitalit themelor te shoqerise dhe te cdo kuote duke perdorur fitimin e realizur .

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje shenimet perkatese ne kuadrin e depozitimit te ketij vendimi.

Shpallur sot me dt.13.05.2005

Gjyqtare
Coco

**Republika e Shqiperise**
**Gjykata e Shkalle pare Tirane**
**Nr........ vendimi**
8816/5

**V E N D I M**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me dt.27.05.2005, une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles Pare Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e administratorit te shoqerise "LORENZO TIRANA" shpk Tirane, *Z. Ilir Haxhiymeri*, me objekt depozitim ne regjistrin tregtar te dokumentave te mbledhjes se ORTAKUT te VETEM te kesaj shoqerie, ne meshtetje te ligjeve Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" Nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

KONSTATOVA:

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 8816 dt. 28.12.1993 shoqeria "LORENZO TIRANA" shpk eshte regjistruar ne regjistrin tregtar me ortake themelues:
- "LORENZO" Srl Gallarate (VA) Itali, person juridik italian, i perfaqesuar nga *Massimo Aliverti* ish Ndermarrjen e Llullave

-Me vendimin Nr. 8816/3 dt. 19.06.1999 te Gjykates se Shkalles Pare, me kerkesen e drejtimit te shoqerise, eshte depozituar ne regjistrin tregtar dokumentacioni ligjor per perqendrimin e kuotave te kapitalit te shoqerise ne nje dore te vetme, si rrjedhoje e transferimit me ane te privatizimit te kuotave qe I perkisnin ortakut shteteror tek ortakut "LORENZO" srl Gallarate (VA) Itali, perfaqesuar nga *Massimo Aliverti*,, I cili pas kesaj zoteron 100% te kuotave te kapatalit te shoqerise.

-Me vendimin Nr. 8816/2 dt. 07.02.2002 te Gjykates se Shkalles Pare Tirane, eshte depozituar ne regjistrin tregtar vendimi I ortakut te vetem Nr. 18/3 dt. 14.02.2002 per rritjen e kapitalit themeltar qe behet 50.000.000 leke, i ndare ne 100 kuota me 50.000 leke secila.

Me vendimin e Ortakut te vetem Nr. 18/5 dt. 23.05.2005 eshte vendosur:
- Te miratohet Relacioni i ekspertit kontabel te autorizuar *Z. Adriatik Beqiraj* me licence profesionale Nr. 72 dt. 31.01.2000, per vleresimin e kapitalit te shoqerise, i ngarkuar nga Ortaku i vetem me vendimin Nr. 18/4 dt. 04.05.2005, vendim i cili eshte depozituar ne regjistrin tregtar me vendimin e Gjykates se Shkalles Pare .
- Te zmadhohet kapitali themeltar, duke pasur parasysh treguesit e relacionit per vleresimin e kapitalit te shoqerise te pergatitur nga eksperti kontabel i autorizuar *Z. Adriatik Beqiraj*,

Nga 50.000.000 (pesedhjete milion) leke i ndare ne 100 kuota me 50.000 leke secila kuote, behet 80.000.000 (tetedhjete milion) leke i ndare ne 100 kuota me 800.000 leke secila kuote.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligje dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE,

ne baze te ligjit Nr. 7512 dt. 10.08.1991, ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992, ligjit Nr. 7667 dt. 28.11.1993 "Per regjistrin tregtar" :

VENDOSA:

1. Pranimin e kerkeses se paraqitur nga administratori I shoqerise "LORENZO TIRANA" shpk *Z. Ilir Haxhiymeri.*
2. Depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise "LORENZO TIRANA" Nr. 18/5 dt. 25.05.2005, i cili permban:

- Miratimin e relacionit per vleresimin e kapitalit te shoqerise te pergatitur nga ekspert kontabel i autorizuar *Z. Adriatik Beqiraj*, mbi bazen e bilancit te veprimtarise se shoqerise dt. 31.12.2004, me tregues kryesore:
  - Aktive 132 374 628 leke
  - Detyrime 247 220 881 leke
  - Kapitale te veta 85 153 747 leke

- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nga 50.000.000 (pesedhjete milion) leke i ndare ne 100 kuota me 50.000 leke secila kuote, behet 80.000.000 (tetedhjete milion) leke i ndare ne 100 kuota me 800.000 leke secila kuote.

3. Te ruaje te pandryshuara gjithe dispozitat e tjera ne statutin e shoqerise.

Pasqyrimin e ndryshimeve perkatese ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles Pare Tirane, ne kolonat 4 dhe 5, me numer rendor 5 dhe ndahen nga njeri tjetri me vize te kuqe.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankese ne Shkalle te dyte

GJYQTARE

Ariana Coco

FIRMA Lorenzo - Tirana
Dt. Krij. 29.12.1993
Kirk.

881611

# Depozitim

(1) URDHËR DEPOZITIMI : dt — gj —

(2) Kërkesë : KËRKUESI : Ilir Haxhiymeri dt 12.1.1996

NR Rep 806 NR kol. —

a) Objekti : rixjerja [illegible] [illegible] [illegible] [illegible]
b) [illegible], [illegible], [illegible], (Akti i Themelimit)
c)

(3) Vendim Asambleje : dt 11.1.1996

NR Rep 870 NR kol 255

ortaku i vetëm —

Ortakët : Marisma Aliverti
Ilir Haxhiymeri

(3) Kontratë shitje kuotash : dt — NR Rep —

SHITËSI : — — % — NR kol —

BLERËSI : — % — —

(4) Vendim i gjyqtarit të vetëm : dt 19.1.1996

NR 8816/1

GJ. Flora Pegu

7) NR i depozitimit në libër : 1778

Tiranë më : 

# S T A T U T

## P E R

## VEPRIMTARIN EKONOMIKE TE SHOQERISE TREGETARE SH P K ME PJESEMARRJEN E KAPITALIT TE HUAJ.

SHOQERIA TREGETARE Shqipetaro-Italiane,e cila me posht do te quhet "LORENZO-TIRANA" eshte krijuar ne baze te AKT THEMELIMIT ndermjet NDERMARJES PRODHIMIT TE LLULLAVE Tirane Shqiperi dhe firmes"LORENZO" Gallarate(VA) Itali,per prodhimin dhe shitjen e llullave.

Te dy palet u moren vesh dhe hartuan statutin si me poshte vijon:

## K r e u I.

## DISPOZITA TE PERGJITHESHME

### N e n i 1

SHOQERIA TREGETARE quhet"LORENZO-TIRANA" SH P K .

SHOQERIA TREGETARE SH P K "LORENZO-TIRANA" eshte person juridik,SHQIPETAR.SHOQERIA TREGETARE SH P K fiton te drejten e personit juridik ne daten e riregjistrimit ne gjykaten e rrethit Tiranes.

### N e n i 2

SHOQERIA TREGETARE SH P K zhvillon veprimtarin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqipetar dhe dekumentat e krijimit(AKT THEMELIMIN DHE STATUTIN).

### N e n i 3

SHOQERIA TREGETARE SH P K krijohet me qellim qe te prodhoj llulla mbrenda Shqiperise dhe te shesi mallin e prodhuar kryesisht per eksport,Ne te arthmen mendohet te trajtohen artikuj prej mareje,alabastre e qeramike per tabakerin,etj.PER vend dhe per eksport.

### N e n i 4

SHOQERIA TREGETARE SH P K e ka selin ne Republiken e Shqiperise ne Tirane,rruga "QEMAL STAFA" Nr.390.(Ajo mund te celi filiale,dege,perfaqesi,ne qytetet e tjera te Shqiperise dhe jashte saja).

Njesit strukturore te SHOQERISE TREGETARE,deget, filialet, dhe perfaqesit e saja,krijohen ne perputhje me legjislacionin Shqipetar e ate te vendeve ku do te ngrihen.

### N e n i 5

SHOQERIA TREGETARE pergjigjet per detyrimet e saja me fondet e veta.

## Kreu II.

## MARREDHENJET EKONOMIKO-FINANCIARE

### Neni 6

ORTAKET gezojne keto te drejta kryesore:

-Administrimin e veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE, ne perputhje me AKT THEMELIMIN dhe STATUTIN.

-Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme e sasie te veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE,parashikuar ne AKT THEMELIMIN dhe STATUTIN e saja.

-Pjesmarrjen me ane te perfaqesusve te vet ne te gjitha organet e SHOQERISE TREGETARE.

-Marrjen e te gjith te dhenave qe kan te bejne me gjendjen ekonomike,tregetare dhe me veprimtarin e SHOQERISE TREGETARE, si bilancet dhe llogarit ekonomike.

-Paraqitjen epropozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Keshilli Administrativ dhe organet e tjera te SHOQERISE TREGETARE.

-Heqjen dore nga SHOQERIA TREGETARE,duke i a ofruar kuoten e vet,sipas zgjedhjes,ORTAKEVE te tjere.Kur nuk behetnje zgjidhje e tille nga ORTAKET,kuota mund t'u cedohet te treteve.

### Neni 7

ORTAKET kane keto detyrime kryesore:

-Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuotat suplementare ne perputhje me AKT THEMELIMIN dhe STATUTIN.

-Te marrin pjese ne administrimin e SHOQERISE TREGETARE nepermjet organeve te krijuara nga ana e vet.

-Ti japin ndermarjes te dhena te domosdoshme per perpunimin e cdo objektivi te vecante lidhur me veprimtarin e saja.

-Te kryejne detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te SHOQERISE TREGETARE.

### Neni 8

Secili ORTAK ka te drejt te heq dore nga SHOQERIA TREGETARE duke i njoftuar vendimin e tij ASAMBLESE se ORTAKEVE nje vit perpara duke ceduar te drejten e zgjedhjes sipas nenit 6.

Heqja dore nuk e liron ORTAKUN nga detyrimet e marra me pare ndaj SHOQERISE TREGETARE dhe nuk pezullon detyrimet e SHOQERISE TREGETARE ndaj ORTAKUT.

ORTAKU doreheqes duhet t'ia ofroj aksionet e tij nje ORTAKU tjeter dhe kur ky i fundit nuk e pranon kete blerje , ORTAKU doreheqes,mbrenda 30 diteve nga njoftimi i doreheqjes mund t'ua shese aksionet e tij te treteve,por jo me cmim me te ulet nga ay i ofruar ORTAKEVE.

## Kreu III.

## KUSHTET EKONOMIKE

N e n i 9

Veprimtaria e SHOQERISE TREGETARE SH P K realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saja

N e n i 10

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE vihet nje kapital baze prej 7.888.220 Leke, 788.220 dollar usa,qe perben burimin fillesatr per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

ORTAKET marrin pjese ne krijimin e kapitalit baze te SHOQERISE TREGETARE me kuotat e tyre qe percaketohen ne AKT THEMELIMIN per krijimin e SHOQERISE TREGETARE.

Menyra dhe afatet e derdhjes se kuotave te kapitalit baze te SHOQERISE TREGETARE caketohen nga Keshilli Administrativ

Keshilli Administrativ u dorzon paleve nje dokument me te cilin vertetohet derdhja e shumave prej tyre.

N e n i 11

ORTAKU qe nuk ka depozituar mbrenda afatit te caketuar kuoten e vet te parashikuar ne kapitalin baze te SHOQERISE, detyrohet t'i paguaj SHOQERISE TREGETARE nje gjobe prej 5 % te shumes qe detyrohet.

N e n i 12

Kur SHOQERIA TREGETARE SH P K,pushon veprimtarin e saj pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka,pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave ju a ndan ORTAKEVE ne perpjestim me kuoten e vene prej secilit per krijimin e kapitalit baze te SHOQERISE TREGETARE.

N e n i 13

SHOQERIA TREGETARE eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejten e perdorimit dhe te disponimit te kesaj pasurie,ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen.

SHOQERIA TREGETARE gezon te drejtat per mbrojtjen e pasurive tesaja,ne perputhje me legjislacionin Shqipetar.

N e n i 14

SHOQERIA TREGETARE krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta financiare (per zhvillimin,e saj per nxitjen ekonomike,te valutes,etj.).

Perberja ,shuma e pergjithshme ,burimet per krijimin e fondit rezerve ,perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante caketohen nga Keshilli Administrativ,ne perputhje me legjislacionin Shqipetar.

SHOQERIA TREGETARE disponon plotesisht mjetet e saj financiare,detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise saj, mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fondet e tjera,ose nga shuma suplementare qe mund te derdhin ORTAKET,kur detyrimet nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuse;

N e n i 15

E ardhura bruto e SHOQERISE TREGETARE ,pasi zbriten, amortizimi i te gjith pasurive te lujtshme e te pa lujtshme, sipas ratave te caketuara,kuotat qe kane te bejne me kredit per investime,pagat dhe shtesat mbi pagat,shpenzimet per lendet e para apo ndihmese,energjia elektrike,si dhe shpenzimet e pergjithshme te reparteve e te ndermarjes dhe ato per qellime te tjera prodhuse zbriten kursimet ne favor te fondit rezerve e fonde te tjera, zbriten tatimet nga Ministria e ekonomise dhe financave,pastaj pjesa qe mbetet ndahet ndermjet ORTAKEVE ne perpjestim me kuoten e pjesemarrjes ne kapitalin baze te SHOQERISE TREGETARE.

Fitimi i ORTAKUT te huaj ,mund te transferohet jashte shtetit pa asnje penges,ne valute ,ose mund te ri investohet ne Shqiperi.

N e n i 16

Pasuria e SHOQERISE TREGETARE vleresohet ne bilancet e saj me vlera te shprehura ne monedh Shqiptare e te huaj,ne perputhje me dispozitat ligjore perkatese te zbatushme ne Shqiperi. Nga ky rregull mund te behen perjashtime nga Ministria e ekonomise dhe financave.

Bilanci vjetor paraqitet mbrenda dates 31.03. te vitit pasardhes.Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike te SHOQERISE TREGETARE caketohen nga organi administrativ i saj duke patur parasysh legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

N e n i 17

Veprimtaria financiare e SHOQERISE TREGETARE realizohet ne baze te planeve financiare,qe bejne pjese ne planin e veprimtari se industriale dhe ekonomiko-tregetare.

Planet financiare parashikojne aktivin dhe pasivin e veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE,te shprehura ne valute te konvertushme.

Llogaria kontabel dhe ajo ekonomike mbahen ne Shqiperi.

Rezultatet financiare te veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE caketohen ne baze te bilancit vjetor.

Shkembimi i monedhes Shqiptare ne monedh te huaj dhe e kunderta behen ne perputhje me kursin e caketuar nga banka e

Shtetit Shqipetar.

## K r e u IV
## ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

### N e n i 18

Organi legjislativ i SHOQERISE TREGETARE SH P K eshte ASAMBLEA E ORTAKEVE.Ne te marrin pjese ORTAKET me te drejte vote,sipas madhesise se shumave te vena per krijimin e kapitalit baze te SHOQERISE TREGETARE.

ASAMBLEA E ORTAKEVE vendos per bilancin vjetor,per ndryshimet ne STATUT,per shtimin ose pakesimin e kapitalit baze te SHOQERISE TREGETARE?,per emerimin e antareve te KESHILLIT ADMINISTRATIV,per emrimin e komisionit te REVIZIO-NIT kontabel,per pushimin e veprimtarise SHOQERISE TREGETARE si dhe per problemet qe nuk jane kopetence e drejtorit dhe zv.drejtorit te pergjithshem.

KESHILLI I ORTAKEVE emron drejtorin dhe zv.drejto-rin e pergjithshem te SHOQERISE TREGETARE.

Uniteti ne vendimet e Asamblese ORTAKEVE eshte i nevojshem per keto ceshtje:

-Ndryshimin e STATUTIT.

-Zgjatjen e kohes se veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE.

-Pushimin e veprimtarise SHOQERISE TREGETARE.

-Rritjen ose pakesimin e kapitalit baze;

-Miratimi i programit vjetor te punes.

-Perfitimin nga rezultatet.

Ne asamblene e ORTAKEVE sicila kuote perfaqesohet nga nje vote.Asamblea e ORTAKEVE te SHOQERISE TREGETARE SH P K ,thirret se paku nje here ne vit,duke lajmeruar me shkrim 30 dite perpara.

### N e n i 19

Organi Administrativ i SHOQERISE TREGETARE SH P K eshte KESHILLI ADMINISTRATIV,i perbere nga 5 antare,qe emero-hen dhe riemerohen ne funksjonet e tyre nga ASAMBLEA e ORTAKE VE,sipas propozimit te ORTAKEVE.Vendosja e kandidateve do te behet sipas kontributit te dhene ne kapitalin themelor te SHOQERISE TREGETARE SH P K;

Antaret e KESHILLIT ADMINISTRATIV caketohen per nje kohe prej jo me shume se 3 vjet,por mandati i tyre mund te perseritet.Secili ORTAK ka te drejte ne cdo kohe te revokoj antarin e k.A.te caketuar sipas propozimit te tij,me kusht

qe te njoftoj kete keshill,duke propozuar nje zevendesus.

KESHILLI ADMINISTRATIV i merr vendimet e veta gjate mbeledhjes se tij.Ne raste te vecanta vendimet merren duke shprehur me shkrim mendimin e secilit votus,ne perputhje me rregullat proceduriale te vendosura nga KESHILLI ADMINISTRATIV.

Cdo antar i KESHILLIT ADMINISTRATIV ka nje vote.Mbledhjet e zakonshme te tij caketohen sipas nevojes por jo me pak se nje here ne dy muaj,duke lajmeruar me shkrim 15 dite perpara dhe duke njoftuar dhe rendin e dites.

Mbledhjet e jashtezakonshme caketohen me kerkesen e secilit ORTAK,me kerkesen e drejtorit ose te zv.drejtorit;

N e n i  20

KESHILLI ADMINISTRATIV eshte kopetent per te marre vendime per cdo aspekt te veprimtarise SHOQERISE TREGETARE.

Kopetencat ekskluzive te tija jane:

-percaketimi i drejtimeve kryesore te veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE,miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike, pas perpunimit te tyre ne kuadrin e objektit te SHOQERISE TREGETARE sipas nenit 3.

-ndryshimin ne emertesen e prodhimit qe do te realizohet dhe te punimeve qe duhet te kryhen ,qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise SHOQERISE TREGETARE.

-propozimet e nevojshme per ndryshimin e kapitalit baze te SHOQERISE qe i behet ASAMBLESE ORTAKEVE.

-percaketimi i rregullave normative qe kufizojne raporte te ne gjirin e SHOQERISE,duke perfshire dhe kuadrin e personelin.

-percaketimi i struktures se aparatit te SHOQERISE.

-paraqitja e propozimeve ASAMBLESE ORTAKEVE Per rregullimin ,krijimin dhe perfitimin nga fondet e vecanta,ndarjen e fitimeve si dhe percaketimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.

-percaketimi i rregullorese per proceduren e punes te KESHILLIT ADMINISTRATIV.

-pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarisese SHOQERISE TREGETARE;

-zgjedhja e antareve te komisionit te likujdimit,te cilet emerohen dhe revokohen nga ASAMBLEA e ORTAKEVE.

-kryerja e veprimtarive per likujdimin e llogarive qe u perkasin ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGETARE.

-marrja e vendimeve per krijimin dhe perdorimin e kredive me afat gjate.

-Kryetari i KESHILLIT ADMINISTRATIV EMEROHET sipas ,

radhes,secili nga antaret e tij per nje kohe jo me shume se 3 vjet.Ay ka per detyre:

-Te organizoj punen e KESHILLIT ADMINISTRATIV.

-Te mbeledh KESHILLIN ADMINISTRATIV;

-Te siguroj zbatimin e sakte te vendimeve te ASAMBLESE ORTAKEVE dhe KESHILLIT ADMINISTRATIV.

Uniteti ne vendimet e KESHILLIT ADMINISTRATIV eshte i nevojshem ne keto ceshtje:

-Hapjen e L/C ne leke dhe ne valute te huaj.

-Lidhjen e disa kontratave.

-Percaketimi i nemurit te punonjesve dhe pagat e tyre.

-Miratimi i cmimeve.

Per ceshtje te tjera KESHILLI ADMINISTRATIV vendos me shumice votash.

N e n i 21

Veprimtaria operative e SHOQERSSE administrohet nga drejtori i pergjithshem i saj dhe nga zv.drejtori i pergjithshem qe perbejne organin ekzekutiv.

Organi ekzekutiv i SHOQERISE merret me keto ceshtje

-Organizon punen per realizimin e planeve te SHOQERISE dhe raporton per to.

-Ne perputhje me programet dhe planet e pergjitheshme administron pasurin e ndermarjes,duke perfshire ketu mjetet financiare mbrenda caqeve te vendimeve te marra nga ORGANI ADMINISTRATIV i SHOQERISE TREGETARE.

-Drejton,kontrollon veprimtarin e filialeve,te degeve e perfaqesive.

-Perfaqeson SHOQERIN TREGETARE perpara te treteve, ne gjykata e ne arbitrazhe,nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te SHOQERISE TREGETARE dhe siguron venjen e tyre ne jete.

-Raporton dhe pergjigjet para KESHILLIT TE ORTAKEVE per zbatimin e veprimtarive te SHOQERISE TREGETARE si dhe per realizimin e objektivave e detyrave qe jane ne koopetencen e tij.

Drejtori i pergjithshem ka kopetence marrjen dhe largimin nga puna te nenpunesave dhe puntoreve te SHOQERISE TREGETARE ne perputhjeme kontraten e punes.

N e n i 22

Per te kontrolluar veprimtarin financiare krijohet komisioni i revizionit kontabel.Kryetari dhe antaret e tij emerohen nga KESHILLI i ORTAKEVE duke zgjedhur ndermjet

bashkepuntoreve te ORTAKEVE.Kryetari i komisionit te revizionit kontabel emerohet per cdo mandat,sipas radhes,nga personat qe perfaqesojne secilin ORTAK.

Komisioni i revizionit kontabel perbehet nga 2 antare.

Komisioni i revizionit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarin e vet perpara ASAMBLESE se ORTAKEVE dhe eshte i detyruar ti paraqese atij cdo vit raporte per kontrollin e bere, si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

Antaret e komisionit te revizionit nuk duhet te jene ne vartesi te SHOQERISE TREGETARE ose te filialeve te saja.

N e n i 23

Marredhenjet e punes ne SHOQERIN TREGETARE ,ne filiale, ne dege ose ne perfaqesi rregullohen nepermjet kontrates pünes.

Per ceshtjet qenuk rregullohen me kontraten e punes sipas legjislacionit Shqipetar zbatohen dispozitat ne fuqi.

K r e u V

MBYLLJA E SHOQERISE TREGETARE SH P K .

N e n i 24

Veprimtaria e SHOQERISE TREGETARE SH P K pushon ne kohen e percaketuar ne AKTIN e THEMELIMIT ose me pare,sipas propozimit te bere nga njeri prej ORTAKEVE,kur gjate 2 vjeteve nuk rezulton rentabel,ose kur te gjithe ORTAKET me perjashtim te njerit,heqin dore nga SHOQERIA TREGETARE,si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dekumentin e krijimit te SHOQERISE TREGETARE,AKTIT te THEMELIMIT.

Ndermarja(SHOQERIA TREGETARE SH P K) SHPERNDAHET NE FORME RIORGANIZIMI OSE LIKUJDIMI.

Ne n i 25

Kur SHOQERIA TREGETARE SH P K likujdohet:

-Keshilli Administrativ emeron komisionin e likujdimit,te cilit i paraqet bilancin e likujdimit dhe SHOQERIA TREGETARE i jep fund veprimtarise se saja ne castin e miratimit te ketij bilanci.

-Pasurit qe jane vene ne dispozicion te SHOQERISE me te drejte shfrytezimi ,i kthehen vendit pronar dhe vleresimi i shfrytezimit te bere llogaritet mbi shumen qe i duhet te kthehet ORTAKUT me prejardhje nga vendi pronar.

-Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE ,e te filialeve te saja dhe fondet financiare ndahen ndermjet ORTAKEVE ne perpjesetim me kuotat e vena,pasi tejene bere pagesat per kreditoret.

Kur pushon veprimtaria e nje filiali per efekt riorganizimi te tij,afatet e pushimit caketohen nga KESHILLI ADMINISTRATIV ne perputhje me marreveshjen e arritur me autorite-tet kopetente te vendit.Likujdimi i filialeve behet njelloj si per SHOQERIN TREGETARE SH P K ,.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprim-tarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te SHOQERISE TREGETARE,pasi tu jene bere pagesat kreditorevet.ORTAKET RANE DAKORT UNANIMISHTE QE ADMINISTRATORI NDERMARJES "LORENZO TIRANA" SH P K ,TE JETE ILIR HAXHIYMERI.

Tirane me 22/12/1993

P/NDERMARJEN E PRODHIMIT LLULLAVET
DREJTORI
ILIR HAXHIYMERI

P/FIRMEN LORENZO
ALIVERTI MASSIMO
AUTORIZUAR ME PROKURE
POLO LESKO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A

Nr. 10523 Rep.
Nr. 3773 Kol.

## V E R T E T I M

Sote me daten 22/I2.I993 ne zyren e noterise Tirane,para meje noteres u paraqiten palet:Ndermarja e Prodhimit te llullave Tirane e perfaqesuar nga Drejtori Ilir Haxhiymeri dhe per firmen Italiane LORENZO Z.MASSIMO ALIVERTI i perfaqesuar me prokure te posacme nga POLO LESKO me Nr.rep.595564 per identitetin e te cileve u vura ne dijeni nga leter njoftimi dhe pasaporta ,madhor ,e me zotesi te plote juridike per te vepruar ,te cilet me deklaruan ne kete STATUT pasi u njohen me permbajtjen e tij e nene-shkruan rregullishte me vullnetin e tyre te lire,cka e vertetoj une si notere ne baze te ligjit me neneshkrimin tim.

N O T E R E

A K T   T H E M E L I M I

PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGETARE TE PERBASHKET

Ndermjet NDERMARJES PRODHIMIT TE LLULLAVE,person juridik ne Tirane(REPUBLIKA E SHQIPERISE) e perfaqesuar nga Z.POLO LESKO, dhe firmes"LORENZO" me seli ne GALLARATE(VA) REPUBLIKA ITALIANE,perfaqesuar nga Z.ALIVERTI MASSIMO,i biri i GIUSSEPES,lindur 19/01/1972 ne BUSSTO ARSIZIO,dhe banus ne GALLARATE(VA) rruga "PASSO DEL GOTARDO" Nr.15,me pasaporte Nr. 388366 I.

Te dy palet u moren vesh per sa vijon:

N e n 1

Te krijohet nje SHOQERI TREGETARE SH P K SHQIPTARO-ITALIANE per te ushtruar veprimtari ekonomike te perbashket e cila do te emertohet si me poshte:

" LORENZO - TIRANA" SH P K .

Kejo SHOQERI do te kete selin e saja ne TIRANE,rruga "QEMAL STAFA" Nr.390 dhe do ushtroj veprimtarin e vet per 10 VJET.

N e n i 2

SHOQERIA TREGETARE"LORENZO-TIRANA" SH P K ,eshte person juridi Shqipetar.Te drejten e personit juridik e fiton ne daten e regjistrimit te saja ne gjykaten e rrethit Tiranes,dhe e zhvillon veprimtarin e saja ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne dekumentat e krijimit te saja (akt themelimi dhe statuti).

N e n i 3

Objekti i veprimtarise se SHOQERISE TREGETARE SH P K eshte:

Prodhimi dhe shitja e llullave kryesisht ne eksport,ne te arthmen mendohet te trajtohen artikujt prej mareje,druri,alabastre e qeramike per tabakeri.

N e n i 4

Kapitali baze i Shoqerise eshte 788.220 dollar usa dhe perbehet nga shumat e derdhura ne para dhe ne natyre nga ORTAKET.

Pjesa e ORTAKEVE ne kapitalin baze te SHOQERISE eshte:

1. PALA SHQIPETARE: 354.700 dollar usa,qe perbehet nga:
   a) 130.700 dollar usa ndertesa.
   b) 50.600 dollar usa makineri e pajisje.
   c) 173.400 dollar usa mjete xhiroje.
2. PALA ITALIANE: 433.520 dollar usa,qe perbehet nga:
   a) 80.000 dollar usa makineri e pajisje.
   b) 34.680 dollar usa teknologji.
   c) 318.340 dollar usa do te derdhen ne banke.

Vleresimi i kontributeve ne natyre behet ne marreveshje

te perbashket nga ORTAKET.Pas kesaj shuma dhe menyra e vleresimit te kontributeve nuk diskutohen me nga ORTAKET.

Vleresimi behet ne monedhe Shqipetare dhe te huaj ne perputhje me rregullat e percaketuara nga Ministria e Ekonomise d Financave te Republikes Shqiperise dhe me kursin zyrtarte bankes shtetit Shqipetar ne diten e neneshkrimit te kesaj marreveshje(ak themelimi).

Duke marre parasysh kontributin e dhene perkatesisht nga ORTAKET per formimin e kapitalit baze,ndermarja Shqipetare do te kete 45 perqind te kapitalit baze dhe pala Italiane do te kete 55 perqind te ketij kapitali.

Likujdimi i kontributeve ne para te ORTAKEVE per formimi e kapitalit baze te SHOQERISE parashikohet te behet sipas nenit 10 te statutit qe i bashkengjitet ketij akt themelimi.

N E N I 5

Kapitali baze i SHOQERISE TREGETARE SH P K sipas nenit 4 te ketij AKT THEMELIMI ,perfaqeson mjetet themelore,te xhiros,etj. te nevojshme per veprimtarin e SHOQERISE dhe depozitohet nga ORTAKE ne banken e Shtetit Shqipetar,ku celen dhe llogarit perkatese.

Ne librin e llogarise se SHOQERISE krijohet "fondithemelu i ORTAKEVE",ku shenohen kapitalet e vena nga secili ORTAK.ORTAKET nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tyre.

N e n i 6

SHOQERIA TREGETARE SH P K e vazhdon veprimtarin e saj dhe pas ri regjistrimit ne gjykaten e rrethit Tirane,ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993.

Fitimi bruto i realizuar nga SHOQERIA TREGETARE do ti neneshtrohet taksave ne masen qe caketohet nga legjislacioni Shqipetar.Pasi zbriten fondet qe do krijoj SHOQERIA (fonde rezerve, fonde te vecanta financiare,etj.)

Fitimi qe do te mbetet do te ndahet:

- Per ORTAKUN e huaj 55 % .
- Per PALEN SHQIPETARE 45 %.

Per rastet kur prodhimi do te shitet ne eksport tre here me i larte(mbi 300 %)se sa shitej ne diten e lidhjes te ketij AKT THEMELIMI,ORTAKU Italian do te marre 5 % te cmimit te faturimit per nje periudhe 3 vjecare.

Pjesa e fitimit qe i takon ORTAKUT Italian munde te transferohet lirisht ne valute.

N e n i 7

Veprimtaria ekonomike e SHOQERISE dhe investimet e pales Italiane ne te,garantohen dhe mbrohen nga Shteti Shqipetar,i cili u siguron atyre kushte te njejta me personat e vet juridik.

N e n i 8

ORTAKU Italian merr persiper:

- Te levroj shtesen e makinave te nevojshme si dhe atrecaturat perkatese mbrenda afatit te caketuar(ne kontraten e bere per krijmin e ndermarjes 25/04/1991).

- Ti jape SHOQERISE dokumentacionin e plote teknik e teknologjik dhe te siguroj se bashku me palen Shqipetare zbatimin e tyre.

